



NGO
Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

5

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

6

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE

7

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

8

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

9-16

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të EC Ma Ndryshe

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të EC Ma Ndryshe, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të EC Ma Ndryshe me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Organizatën, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim

i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj – Auditor Ligjor

ACA – Audit & Consulting Associates

Prishtinë, Kosovë

29 mars, 2024




EC Ma Ndryshe
Pasqyra e pozicionit financiar
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
PASURITË	Shënime		
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	89,147	84,088
Totali i pasurive qarkulluese		<u>89,147</u>	<u>84,088</u>
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i pasurive jo-qarkulluese		<u>-</u>	<u>-</u>
TOTALI I PASURIVE		<u><u>89,147</u></u>	<u><u>84,088</u></u>
REZERVAT DHE DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme		-	-
Të hyrat e shtyera	4	89,147	84,088
Totali i detyrimeve afatshkurta		<u>89,147</u>	<u>84,088</u>
Rezervat dhe detyrimet			
Fondet në fillim të vitit		-	-
Teprica/(Mungesa) për vitin		-	-
Totali i rezervave dhe detyrimeve		<u>-</u>	<u>-</u>
TOTALI I REZERVAVE DHE DETYRIMEVE		<u><u>89,147</u></u>	<u><u>84,088</u></u>

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 29 mars, 2024 nga:


Valon Xhabali



Drejtor Ekzekutiv



Admir Istrefi



Menaxher Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

EC Ma Ndryshe
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
	Shënime		
Të hyrat			
Të hyrat nga donacionet	5	<u>276,281</u>	<u>244,068</u>
Totali i të hyrave		276,281	244,068
Shpenzimet			
Shpenzimet projektit	6	187,717	147,665
Shpenzimet projektit	7	71,269	81,740
Shpenzimet administrative	8	8,500	5,574
Shpenzimet e qirasë	9	7,135	7,660
Provizionet	10	800	570
Shpenzimet e auditimit		860	860
Totali i shpenzimeve		<u>276,281</u>	<u>244,068</u>
Teprica/(Mungesa) për vitin		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

EC Ma Ndryshe
Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Total
Bilanci me 1 janar 2022	-
Teprica/(Mungesa) për vitin	-
Bilanci me 31 dhjetor 2022	-
Bilanci me 1 janar 2023	-
Teprica/(Mungesa) për vitin	-
Bilanci me 31 dhjetor 2023	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

EC Ma Ndryshe
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në vleren EUR)

	Fundi i vitit 31 dhjetor 2023	Fundi i vitit 31 dhjetor 2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Deficiti per periudhën		
Rregulluar për:		
Zhvlerësimin	-	-
Të hyrat e shtyera	5,059	54,233
Të pagueshmet	-	-
Net cash from Operations	5,059	54,233
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur për aktivitetet investuese	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Pagesa të parasë për aktivitetet financuese	-	-
Paraja neto e përdorur për aktivitetet financuese	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	5,059	54,233
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 janar	84,088	29,855
Paraja dhe ekuivalentet më 31 dhjetor	89,147	84,088

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

1. INFORMATAT GJENERALE

OJQ Ma Ndryshe ("EC Ma Ndryshe"), është themeluar në vitin 2006 me numër fiskal 600523783, dhe adresë: Fehmi Lladrovci NR. 94 Prizren. EC është organizatë e përkushtuar për avancimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë.

Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh komunitetesh, si dhe mban presion të përhershëm ndaj pushteteve vendore për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme. EC është e përkushtuar për qytetari aktive në formësimin e mjedisit jetësor duke promovuar organizimin e duhur të komunitetit, demokratizimin e institucioneve dhe pasurimin e jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Nga janari 2015, EC operon me këto tre programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizimi i komunitetit), Qeverisja e Mirë (monitorimi dhe avokimi), Hulumtimi (prodhimi i njohurive).

Karakteristikat e veçanta të EC janë: një, fokusi gjeografik dhe dy, qasja ndaj çështjeve me interes. Me seli në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike për hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet kërkimore të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi ato merren me thelbin e problemit dhe jo me simptomat.

Për më tepër, EC mbulon fusha specifike si planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi hapësinor publik dhe të ngjashme, të cilat përgjithësisht janë të nëntrajtuara në Kosovë. Aktiviteti kërkimor dhe aktivizmi bazë i organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC është e angazhuar vazhdimisht në punën me grupet e komunitetit për të identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burimet që ushqejnë komponentin e kërkimit. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh në axhendën e politikëbërjes, pasi idetë vijnë nga poshtë, ndërsa mundësitë për përfshirje politike krijohen paralelisht me krijuesit në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar.

EC Ma Ndryshe është një nga themeluesit dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin Evropian në Juglindje të organizatave të trashëgimisë kulturore - SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themelues i Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, i Rrjetit të Organizatave Kulturore në Prizren dhe i Rrjetit të Organizatave të Pavarura Kulturore në Kosovë – Forumi Kulturor.

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Baza e përgatitjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë

2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për organizatën janë përgaditur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e organizatës si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjyqimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se organizata do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të operimit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

2.2.2 Njohja e te hyrave

Të hyrat njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të hyrave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.3 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njej si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njej pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.2.4 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

2.2.5 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paraja ne bankë - BKT 137	59,855	1
Paraja ne bankë - BKT 889	18,107	15,334
Paraja ne bankë - BKT 986	9,548	31,673
Paraja ne bankë - BKT 404	500	-
Paraja ne bankë - BKT 113	302	787
Paraja ne bankë - BKT 792	233	3,871
Paraja ne bankë - BKT 695	0	17,319
Paraja ne bankë - BKT 598	-	12,187
Paraja ne bankë - BKT 210	-	2,772
Paraja në arkë	600	144
Total paraja dhe ekuivalentët e parasë	89,147	84,088

4. TË HYRAT E SHTYERA

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të hyrat e shtyera		
Të hyrat e shtyera MKRS	59,855	-
Të hyrat e shtyera CARITAS	18,369	15,337
Të hyrat e shtyera CDF-SIDA	9,628	25,494
Të hyrat e shtyera KCSF	-	10,334
Të hyrat e shtyera KCSF/EJA	-	6,985
Të hyrat e shtyera FLOSK/UNDP Filigrani	-	6,453
Të hyrat e shtyera ATRC	-	6,414
Të hyrat e shtyera LUX	-	2,451
Të hyrat e shtyera KFOS	-	2,377
Të hyrat e shtyera UNDP	-	1,545
Të hyrat e shtyera nga projektet e vogla	1,294	6,697
Total të hyrat e shtyera	89,147	84,088

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

5. TË HYRAT NGA DONACIONET

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të hyrat nga donacionet		
Të hyrat nga CDF SIDA	81,970	106,662
Të hyrat nga MKRS	80,000	-
Të hyrat nga Caritas	44,298	17,719
Të hyrat nga KCSF/EJA	38,300	38,300
Të hyrat nga UNDP	19,156	5,500
Të hyrat nga GIZ 2	15,816	-
Të hyrat nga DKRS	900	10,000
Të hyrat nga GAP Institute	900	900
Të hyrat nga UNDP 2	-	45,125
Të hyrat nga OPIC	-	39,765
Të hyrat nga GIZ	-	30,566
Të hyrat nga Democracy +	-	2,167
Të hyrat nga Civikos	-	897
Të hyrat nga CoE	-	700
Të hyrat e shtyera nga viti i kaluar	84,088	29,855
Të hyrat e shtyera	(89,147)	(84,088)
Total të hyrat nga donacionet	276,281	244,068

6. SHPENZIMET E PROJEKTit

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzimet e projektit		
Shpenzimet për CDF SIDA	71,324	47,823
Shpenzimet për KCSF/EJA	32,177	7,321
Shpenzimet për Caritas	31,249	-
Shpenzimet për UNDP	22,502	9,395
Shpenzimet për GIZ 2	15,809	-
Shpenzimet për MKRS	11,431	-
Shpenzimet për GIZ	2,836	23,150
Shpenzimet për DKRS	388	7,599
Shpenzimet për UNDP 2	-	28,060
Shpenzimet për OPIC	-	22,993
Shpenzimet për KFOS	-	933
Shpenzimet për CoE	-	390
Total shpenzimet e projektit	187,717	147,665

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

7. SHPENZIMET E PAGAVE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzimet e pagave		
Shpenzimet për CDF SIDA	28,098	28,728
Shpenzimet për KCSF/EJA	19,215	20,265
Shpenzimet për Caritas	9,456	2,364
Shpenzimet për MKRS	8,700	-
Shpenzimet për UNDP	5,800	2,280
Shpenzimet për OPIC	-	13,415
Shpenzimet për UNDP 2	-	7,738
Shpenzimet për KFOS	-	650
Shpenzimet për GIZ	-	3,900
Shpenzimet për DKRS	-	2,400
Total shpenzimet e pagave	71,269	81,740

8. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzimet administrative		
Shpenzimet për CDF SIDA	1,947	1,831
Shpenzimet për KCSF/EJA	1,688	1,444
Shpenzimet për GAP Institute	1,504	33
Shpenzimet për D+	1,113	207
Shpenzimet për UNDP	1,001	214
Shpenzimet për Civikos	645	-
Shpenzimet për Caritas	538	-
Shpenzimet për CoE	64	-
Shpenzimet për GIZ	-	665
Shpenzimet për OPIC	-	516
Shpenzimet për UNDP 2	-	410
Shpenzimet për KFOS	-	235
Shpenzimet për Caritas	-	18
Total shpenzimet administrative	8,500	5,574

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

9. SHPENZIMET E QIRASË

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzimet e qirasë		
Shpenzimet për KCSF/EJA	2,400	2,200
Shpenzimet për UNDP	2,000	-
Shpenzimet për SIDA	1,650	1,800
Shpenzimet për D+	900	-
Shpenzimet për Civikos	185	-
Shpenzimet për OPIC	-	2,760
Shpenzimet për UNDP 2	-	900
Total shpenzimet e qirasë	7,135	7,660

10. PROVIZIONET

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Provizionet		
Provizionet për CoE	228	8
Provizionet për CDF SIDA	216	126
Provizionet për KCSF/EJA	140	84
Provizionet për GAP Institute	74	75
Provizionet për D+	73	2
Provizionet për UNDP	39	45
Provizionet për DKRS	13	-
Provizionet për GIZ 2	11	-
Provizionet për Civikos	5	89
Provizionet për GIZ	4	15
Provizionet për UNDP 2	-	39
Provizionet për KFOS	-	9
Provizionet për OPIC	-	80
Total provizionet	800	570

EC Ma Ndryshe

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

11 KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

11.1. Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

12 NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.